




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
GJIROKASTËR**



Nr.45[Akti
Dt.24.02.2014

Nr.21-2014-343 (45) Vendimi
dt.04.04.2014

**V E N D I M
N E E M E R T E R E P U B L I K E S**

Gjykata e Rrethi Gjyqesore Gjirokastrer e perbere prej:

GJYQTAR: Pellumb Vehbi

Me sekretare Marjanthi Kosta, me pjesmarjen e prokurorit Julian Çafka ne daten 04.04.2014 ne séance gjyqesore me dyer te hapura shqyrtoi ceshtjen penale me

KERKUES : - Kristian Skendaj i biri i Velo i dl.16.05.19675, banues ne Vlore, mbrojtur dhe perfaq. nga av. Benard Aliko.
-Aurora Malja e bija e Ferdinand e dl.16.03.1981, banuse ne Vlore, mbrojtur dhe perfaq.nga av. Benard Aliko.

Objekti : Kthim mjetit te sekuestruar autoveture BMW X-6 ngjyre e zeze , targa A600HS, nr. shasie WBAFH01050L466505 dhe dokumentacionin Leje Qarkullimi nr.VLD 0965213 , nr.0679591 shtetases Aurora Malja , Polic-Sigurimi nr.serie 0476753 date 14.06.2013e automjetit me targa AA600HS, Çertifikate kontrolli teknik targa AA600HS nr.serie 0878019, Çertifikate pronesia e mjetit BMW X-6 me targa AA600HS, Leter-Njoftimi i shtetasit Kristian Skendaj nr.H 50516043 V, Fature Tatimore nr.111685062 date 28.01.2013 ne emer te shtetasit Kristian Skendajdhe 69.400 euro te sekuestruara ne date 15.01.2014 ne pronesi te Aurora Malja.

Baza Ligjore : Neni 301/2 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoj ne teresi ceshtjen , degjoi ankuesit qe kerkuan pranimin e kerkeses , degjoj prokurorin qe kerkoj rrezimin e kerkeses.

V E R E N

Kerkuesit Kristian Skendaj dhe Aurora Malja me kerkesen objekt gjykimi kerkon kthimin e sendeve te sekuestruara :

- a-Leter-Njoftimi i shtetasit Kristian Skendaj nr.H 50516043 V
- 1-Autoveture BMW X-6 ngjyre e zeze , targa A600HS, nr. shasie WBAFH01050L466505
- 2- Leje Qarkulliminr.VLD 0965213 , nr.0679591
- 3- Polic Sigurimi nr.serie 0476753 date 14.06.2013 e automjetit me targa AA600HS,
- 4- Çertifikate kontrolli teknik targa AA600HS nr.serie 00973826,
- 5- Raport i kontrollit teknik te mjetit me targe AA600HS date 29.10.2013
- 6- Çertifikate pronesia e mjetit BMW X-6 me targa AA600HS nr.serie 0878019,

- 7- Fature Tatimore nr.111685062 date 28.10.2013
- 8- Kthimit te shumes 69.400 euro
- 9 -Leter-Njoftimi i shtetasit Kristian Skendaj nr.H 50516043 V

Nga shqyrtimi gjyqesor i çeshtjes rezulton se sendet objekt kerkimi kerkuesit Kristian Skendaj i jane sekuestruar me procesverbalin e dt. 15.01.2014 ora 16.52 nga O.P.GJ Gjirokaster dhe eshte vleresuar nga prokuroria e rrethit gjyqesor Gjirokaster me vendimin e dt. 17.01.2014.

Sekuestrimi eshte bere ne rrethanat e meposhtme :

Ne date 15.01.2014 ora 16.52 sherbimet e policise gjyqesore te DR.Pol-Qarku Gjirokaster gjat sherbimit ne vendin e quajtur Gerhot nga kontrolli te automjetit tip BMW-X-6 me targa AA600HS me drejtues mjeti Kristian Skendaj dhe pasagjer shtetasin Artan Xheza kane gjetur ne bagazhin e tij 69.400 euro prerje 20-she.

Automjeti dhe shuma e mesiperme u sekuestruan me procesverbalin e dates 15.01.2014 te OPGJ dhe u vlefesua sekuestrimi me vendimin e prokurorise date 17.01.2014.

Ne date 17.01.2014 prokuroria ka regjistruar procedimin penal per vepren penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Ne gjykim kerkuesit deklaruan se : bashkejetojne prej vitesh, kane qene se bashku ne emigracion ne shtetin italjan dhe pasi jane kthyer ne shqiperi meren me shitblerje pasurish . Kerkuesit, kerkojne kthimin e sendeve te sekuestruara pasi mjetin BMW-X-6 me targa AA600HS eshte ne pronesi te kerkueses Aurora Malja, ndersa shuma 69.400 euro eshte kontribut i perbashket nga puna ne emigracion jane depozituar ne BKT dega Vlore ne emer te kerkueses Aurora Malja dhe jane terhequr nga banka prej saj me qellim per te blere nje apartament ne qytetin e Sarandes.

Pretendimet e mesiperme kerkuesit i provuan ne gjykim me praktiken dokumentare te BKT dega Vlore, dokumentacionin e automjetit BMW-X-6 dhe te dhenat e punesimit te kerkueses Aurora Malja ne shtetin italjan.

Prokuroria ne gjykim prapsoi kerkimet e kerkuesve dhe kerkoi rezimin e kerkeses duke parashtruar se :

Sekestrimi i sendeve objekt kerkimi eshte bere per shkak hetimi pasi dy personat te cilet udhetonin se bashku kane dhene deklarime te ndryshme lidhur me sasine eurove te gjetura. Sasia e eurove te cilat qarkullonin jashte sistemit bankar le te dyshohet per origjinen e tyre. Mbajtesi i shumes Kristian Skendaj ka pasur nje procedim penal nga prokuroria e Vlores per vepren penale "Trafikimi i mjeteve motorike" .

Lidhur me makinën dyshojme se eshte e kerkuesit Kristian Skendaj pasi ku person eshte gjendur ne drejtimin e mjetit dhe mund te jete rezultat i te njejtit veprimtari te pastrimit te produktit te vepres penale

Pretendimet e mesiperme prokuroria i provoi me process-verbalin e sekuestrimit te sendeve dt.15.01.2014, vendimin e vlefesimit dt. 17.01.2014 dhe gjith praktiken hetimore administruar ne gjykim bashkengjitur fashikullit gjyqesor.

Sa me siper Gjykata çmon se mjeti ka pasur bleres dhe eshte ne pronesi te kerkueses Aurora Malja, me dokumenta te regullta regjistrimi ne DRSHT.Rugor Vlore , kerkuesia nuk dyshohet te jete perfshire ne ndonje veprimtari kriminale ose te dyshohet se ka kryer ndonje veper penale dhe automjeti eshte produkt i perftuar prej tyre.

Ne te kundert ne gjykim u provua se kerkuesia Aurora Malja ka punuar ne shtetin italjan , ka perftuar te ardhura i ka depozituar te ardhurat ne emer te saj ne BKT dega Vlore, automjeti BMW - X - 6 ka dukumentacion te rregullt dhe ne mungese te provave ose indicejeve per ekzistencen e precedenteve penale kunder saj dhe gjykata çmon se automjeti ti kthehet ne ruajtje pronares Aurora Malja pasi ka nje vlere, eshte i ri dhe kerkon nje perkujdesje ne administrimin e tij.

Lidhur me sekuestrimin e Shumen 69.400 euro te cilat jane sekuestruar ne posedim te kerkuesit Kristian Skendi gjykata pavaresisht pretendimeve te paleve ne gjykim kostaton se eshte e vertete se kerkuesit Kristian Skendi dhe Aurora Malja bashkejetojne prej vitesh, kerkuesia Aurora Malja ka pas depozituar ne BKT dega Vlore nje shume rreth 75.000 euro te cilat i ka

terhequr ne date 16.10.2012, kerkuesit ne gjykim pretenduan se nuk jane te punesuar dhe jetojne me shit-blerje pasurie, pretendime keto te pa provuara.

Njekohesisht ne deklarimet e tij te dates 10.01.2014 dhene me cilesine e personit ndaj te cilit zhvillohen hetimet, kerkuesi Kristian Skendi ka pohuar se ka qene dy here i denuar ne shtetin Italian per vepren penale te vjedhjes, prokuroria pretendon se ndaj tij ka nisur nje procedim penal per vepren penale te trafikimit te mjeteve motorike, fakt i pa kundershuar dhe nga kerkuesi Kristian Skendi.

Sa me siper gjykata mbeshtetur ne te dhenat e administruara ne gjykim çmon se ka indicje te mjaftushme per nje hetim te metejshem lidhur me origjinen e shumes se eurove te sekuestruara dhe gjykata vlereson se sekuestrimi i shumes duhet te vazhdoje deri ne perfundimin e procedimit te nisur.

Perfundimisht Gjykata bazuar ne nenin 214 e vijues te K.Pr.Penale automjeti BMW-X-6 me targa AA600HS duhet ti lihet ne ruajtje dhe kujdesje pronares , kerkueses Aurora Malja, ndersa shuma 69.400 euro te cilat jane sekuestruar ne posedim te kerkuesit Kristian Skendi gjykata te vazhdojne te qendrojne nen ruajtje sipas percaktimeve te nenit 214 te K.Pr.Penale.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne Nenin 217 e 384 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Pranimin e pjesshem të kërkeses

-Kthimin e sendeve të sekuestruar me proces-verbalin e sekuestrimit të provës materiale, datë 15.01.2014 ora 16.52 dhe konkretisht:

a-Leter-Njoftimi i shtetasit Kristian Skendaj nr.H 50516043 V

1-Autoveture BMW X-6 ngjyre e zeze , targa A600HS, nr. shasie WBAFH01050L466505

2- Leje Qarkullim nr.VLD 0965213 , nr.0679591

3- Polic Sigurimi nr.serie 0476753 date 14.06.2013 e automjetit me targa AA600HS,

4- Çertifikate kontrolli teknik targa AA600HS nr.serie 00973826,

5- Raport i kontrollit teknik te mjetit me targe AA600HS date 29.10.2013

6- Çertifikate pronesis e mjetit BMW X-6 me targa AA600HS nr.serie 0878019,

7- Fature Tatimore nr.111685062 date 28.10.2013, shtetases Aurora Malja me kusht qe per nevoja hetimi automjetin dhe dokumentacionin perkates ta vere ne dispozicion te Prokurorise te Rrethit Gjyqesor Gjirokaster dhe moslejimin e tjetersimit apo demtimit te tij .

-Rezimin e kerkimit per kthimin e shumes 69.400 euro të sekuestruara me proces-verbalin e sekuestrimit të provës materiale, datë 15.01.2014 ora 16.52 vleftesuar me vendimin e prokurorise date 17.01.2014.

-Shpenzimet procedurjale sic jane kryer.

-Kunder vendimit lejohet ankim brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes te tij ne Gjykatën e Apelit Gjirokaster.

U shpall me 04.04.2014

Sekretare
Marjanthi Kosta



GJYQATAR
PELDUMB VITIBI



Shenim: Vendimi ka marre forme te prere me date 11.06.2014, pasi eshte ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Gjirokaster.
Me vendimin Nr.131/445, me date 11/06/2014 te Gjykates te Apelit Gjirokaster eshte vendosur Lenien ne fuqi te vendimit penal nr.343/45, date 04.04.2014 te Gjykates te Rrethit Gjyqesore Gjirokaster .

**KANCELARE
DONALDA FERUNI**